



**Hapet thirrja për mobilitete studentësh të UPT-së,
në Saxion University of Applied Sciences, Holandë**

Në kuadër të programit Erasmus+ dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në Saxion University of Applied Sciences.

Lloji i mobilitetit përfshin: Pjesëmarrje në mobilitet një javor, nga data 17 – 21 nëntor 2025, të studentëve nga Departamenti i Urbanistikës, të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, viti i tretë dhe i katërt i studimit.

Nivelet e mobilitetit për studentët: Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Departamenti i Urbanistikës.

Tema e programit të planizuar: *Affordable housing and sustainable construction*

Numri total i studentëve: 8 studentë

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

*Niveli minimal i kërkuar është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘Mobility Plan’.

Dokumenti ‘Learning Agreement’ te seksioni ‘Commitment’ firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Afati për aplikim: Deri më 10 shtator 2025, ora 12.00

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Studentët e interesuar për mobilitet të kontaktojnë me drejtuesen e Departamentit të Urbanistikës, Dr. Jonila Prifti.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, mund të kontaktoni në e-mail: abeqo@upt.al , rkodra@upt.al